



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLICA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njesia Org. Org. Unit	02
Nr Prot. Prot. No	05-2163
Nri faqever Gr.stranica	- 2 -
Date:	06/04/2023
No pages	
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Ured Generalnog Sekretara / Office of the Secretary General

Prishtinë, 06.04.2023

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7 /01 Mars 2019), me qëllim të zbatimit të nenit 49 të Ligjit Nr. 04/L-125 për shëndetësi, nxjerr:

Qarkore Informative Nr. 4 /2023

Për: Shërbimin klinik universitar të Kosovës
Qendrën klinike universitare të Kosovës
Spitalet rajonale
Drejtorët e Departamentit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komuna
Drejtorët e Qendrave Kryesore të Mjekësisë Familjare
Institucionet Private Shëndetësore
Specializantët, Mentorët Klinik dhe Kryesuesit e Komiteteve

Qëllimi: Informimi për përdorim të Sistemit të Informimit Shëndetësor, përkatësisht të BHIS, SMSF, sistemin e resurseve humane (modulin e Punëtorit Shëndetësor), modulin e vaksinave, modulin e vizitave në shtëpi, modulin e licencimit të IPSH-ve dhe modulin e specializantëve

Obligimet e institucioneve shëndetësore dhe akterëve tjerë:

- SHSKUK, QKUK dhe Spitalet Rajonale janë të obliguara të zbatojnë BHIS për pacientat jo spitalore në ambulancat specialistike, SMSF në klinika dhe reparte, sistemin e resurseve humane (modulin e Punëtorit Shëndetësor)
 - Përdorimi i BHIS duhet të vazhdoj edhe nëse ka mungesë të tonerëve
 - Përmes SMSF duhet të menaxhohet i gjithë stoku i produkteve medicinale (barna dhe material shpenzues)
 - Të gjitha të dhënat e punëtorëve duhet regjistruar në sistemin e resurseve humane (modulin e Punëtorit Shëndetësor)
- Të gjitha Institucionet e KPSH janë të obliguara të zbatojnë BHIS, SMSF, sistemin e resurseve humane (modulin e Punëtorit Shëndetësor), modulin e vaksinave dhe modulin e vizitave në shtëpi
 - Përdorimi i BHIS duhet të vazhdoj edhe nëse ka mungesë të tonerëve

- Secila QKMF duhet që përmes SMSF të menaxhoj të gjithë stokun e produkteve medicinale (barna dhe material shpenzues).
 - Barnatoret e QKMF-ve duhet të përdorin modulën “Dalje për pacient” i cili është pjesë e SMSF-së
 - Të gjitha të dhënat e punëtorëve duhet regjistruar sistemin e resurseve humane (modulën e Punëtorit Shëndetësor)
 - Përdorimin e modulit të vaksinave për aplikimin e vaksinave të rregullta dhe me indikacione, vakcina kundër Covid19
 - Përdorimin e modulit të vizitave në shtëpi për regjistrimin e vizitave në shtëpi
- Të gjitha Institucionet Private Shëndetësore janë të obliguara të përdorin modulën e licencimit të Institucioneve Private Shëndetësore:
 - Aplikimet për licencim apo rilicencim duhet të bëhen në formën online në modulën e licencimit të Institucioneve Private Shëndetësore
 - Të gjitha kërkesat për ndryshim stafi, ndryshim orari etj duhet të realizohen përmes sistemit
 - Të gjithë specialistët, mentorët klinik dhe kryesuesit e komiteteve janë të obliguar të përdorin modulën e specialistëve:
 - Aplikimet për specializime duhet të bëhen në formën online në sistemin për specialistë
 - Vijueshmeria e specialistëve, kërkesat e ndryshme duhet të regjistrohen në sistem



Dr. Naim Bardhi
Sekretar i Përgjithshëm, MSh

Qarkorja i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit
- SHSKUK
- Inspektoratit Shëndetësor
- Inspektoratit Farmaceutik
- Drejtorëve të DShMS në Komuna dhe Drejtorëve të QKMF-ve
- Udhëheqësit të Departamentit Ligjor
- Udhëheqësit të Divizionit për Kujdesin Parësor Shëndetësor
- Udhëheqësit të Departamentit të SISH-it
- Udhëheqësit të Divizionit Farmaceutik
- Arkivit